

Procesverbal

Nga mbledhja II (e dytë) e jashtëzakonshme e Kuvendit Komunal në Dragash , e mbajtur më datë:24.11.2023

Rend Dite

- 1) Shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
- 2) Rishqyrtimi i Vendimit për korrigjim për listat kadastrale, 01Nr.060/01-8154-2/23, i datës 27.04.2023, dhe
- 3) Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta, KEDS Sh.A. Prishtinë.

Uran Halimi: Përshëndetje të nderum delegatë, mirë se keni ardhë në Mbledhjen II të jashtëzakonshme, është e 11-ta me radhë për vitin 2023 të Kuvendit të Komunës së Dragashit, ku njëherit thirrësit e kësaj seance kanë propozuar këtë rend të ditës: të parën e kemi shkarkimin e kryesuesit të Kuvendit; pika e dytë është Rishqyrtimi i Vendimit për korrigjim për listat kadastrale; dhe pika e tretë edhe e fundit është Propozim Vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta. Përpara se me vazhdue me procedimin e kësaj seance, unë deshta me e marrë fjalën, me i thënë nja dy fjalë, meqenëse po diskutohet për shkarkimin e kryesuesit. Së pari po filloj me thirrjen e kësaj seance. Te thirrja e kësaj seance ka shkelje në faqen e parë, këtu ku nënshkrimi është vendos te vendi ku unë është dashtë me nënshkrue. Kanë mund me nënshkrue kushdoqoftë tjetër, po jo te vendi jem. Domethënë ka nënshkrue Urani në këtë rast, nëse jeni t'u e pa te fetsa. Është shkelje procedurale, mirëpo me këtë çështje do të vazhdojmë me u marrë pas kësaj seance. Realisht, kur e pashë z.Mehmet Spahiun, mendova që do ta fillojë edhe seancën, me vazhdue me shkeljen tjetër procedurale, po e kuptoi që është e gabueshme. Te shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, kjo është vazhdë e pabesive që kjo qeverisje po vazhdon me jau bo, së pari votuesve, mbështetësve më të sinqertë, votuesve të LVV-së. Po fillojmë së pari me tradhtinë e koalicionit. Mandej, mocionin për shkarkim në pikën eventuale. Mandej mocioni për shkarkim në seancë të jashtëzakonshme. Me këtë, jo vetëm që po vazhdohet me pabesi, po dëmtohet në këtë rast edhe qytetari, se ne jemi ata që pas vetes bartim qindra vota, edhe po besoj që s'është vullneti i qytetarit, e as në të mirën e qytetarëve shkarkimi i kryesuesit në këtë moment. Sidoqoftë, ju kisha ftuar, sidomos juve delegatëve të opozitës, që mos me e përkrah këtë votim, për shkak të atyre votave që ju i përfaqësoni në Kuvend. Mos bini pre e një qeverisje, në njëfarë mënyre, okupuese, kapëse e çdo institucioni të kësaj Komunës. Mirëpo, prapë se prapë, jeni ju ata të cilët vendosni. Kanë qenë këta, pozita, ata që më kanë votu, kanë insistu. Me siguri juve ju kujtohet, kogja zor i patën

dhonë kur është emëruar kryesuesi, me 2 milionë mosmarrëveshje brenda tyre. E, sot po e vazhdojnë atë punën që e kanë fillu, duke e tradhtu secilin qytetar të Komunës së Dragashit. Për pikat tjera s' due me marrë fjalë edhe me vazhdu. Unë ju ftoj, nëse keni dikush me e marrë fjalën, përpara se ta hedhim në votim këtë rend të ditës, urdhëroni, mundeni me e marrë fjalën. Fjalën e ka kërkue së pari Shpetim Hajredini dhe pastaj Driton Ademi dhe vazhdojmë me radhë.

Shpetim Hajredini: Faleminderit, i nderuar kryesues! Përshendetje të nderuar kolegë asambleistë, qytetarë të nderuar të Dragashit, ju përshëndes të gjithëve! Unë kur e pashë realisht thirrjen për seancë, mendova që kemi naj pikë të rëndësishme që ka vlerë dhe që ka të bëjë me të mirën e qytetarëve. Por pastaj, pasi e hapa dhe fillova ta lexoj, pashë që kjo ka të bëjë me çështje politike dhe aspak nuk ndikon tek qytetarët. Por, pasi që veç jemi tubuar dhe kemi obligim që të jemi në seancë në çdo thirrje e cila na vjen nga ekzekutivi, atëherë patjetër që, si shef i Grupit të PDK-së, jam i obliguar që edhe ta marr fjalën dhe të jap mendimin tim personal, por gjithashtu edhe mendimin e përgjithshëm të PDK-së, sa i përket pikës së parë të rendit të ditës për shkarkimin e kryesuesit. Natyrisht, unë detyrohem që të kthehem nga dy vite mbrapa, për hir të qytetarëve, që ta kenë sa më të qartë qytetarët se përse sot jemi tubuar dhe çka ndikon ky takim për ta. Para dy viteve, unë e kam shumë të freskët memorien, se po këta asambleistë, e emëruan dhe e votuan Uran Halimin që të jetë kryesues i Kuvendit Komunal të Dragashit. Si për çudi, të njëjtit nënshkrime i pashë në thirrjen e Asamblesë, me përjashtime të vogla, që janë po të njëjtë ata të cilët sot po kërkojnë që Uran Halimi të shkarkohet. Edhe arsytimi që për mu është aspak i qëndrueshëm, ka bërë shkelje sistematike të Rregullores së Punës së Kuvendit. Do të vazhdoj të flas edhe më tutje për periudhën kohore të para dy viteve. Ne e kemi shumë të freskët atë që ju kemi thënë në atë kohë, por besoj që edhe juve ju kujtohet Uran Halimi, se këta që sot po jua pranojnë të gjitha ofertat juve, po sillen në mënyrën më të mirë të mundshme me ju, shumë shpejt do ju tradhtojnë. Por, në atë kohë ju nuk i morët për bazë këshillat tona. Dhe ajo çfarë ndodhi më pas, e dimë ne të gjithë sa kohë kaloi dhe ajo lidhje e juaj e bujshme përfundoi shumë shpejt. Premtimet të cilat jau dhanë juve dhe atyre qytetarëve të cilët votuan për ta, duke ndikuar ju, i mori lumi. Mirëpo, kjo për ne të PDK-së nuk ishte çudi, pasi që ne e kemi prit një gjë të tillë. Ajo çka ju mbeti juve të VV-së nga ajo bujë e madhe e lidhjes suaj, e koalicionit tuaj të shpresës për Dragashin, ishte vetëm kjo pozitë. Pozita e kryesuesit. Dhe, edhe këtë pozitë sot, edhe këtë premtim sot ky ekzekutiv po e shkel. Dhe, ju tani po mbeteni të zymtë, po mbeteni të shkatërruar. Por, unë jam i bindur që ju do të vazhdoni tutje sepse, tek e fundit, po mos të kishim qenë ne, ju shumë shpejt, mos të them ndoshta dy-tre muaj, ju do të kishit qenë të shkarkuar dhe kjo temë do të ishte e harruar. Ju që para dy viteve i keni bo votat dhe e emëruat këtë kandidat, besoj që edhe sot i keni prapë votat për ta shkarkuar Uranin nga ky pozicion në të cilin është. Ne në atë kohë nuk ishim pro, prandaj edhe sot ne nuk do të jemi pro shkarkimit të kryesuesit. Për ne ka

qenë një kryesues stabil, i cili ka punuar në të mirën e qytetarëve, ka qenë ai i cili ka bashkëpunuar me kryetarin, ka qenë ai i cili asnjëherë nuk na ka ndaluar ta marrim fjalën. Besa, ka pas edhe prej nesh që edhe pa na e dhënë fjalën, kena dalë e kena marrë. Me një rast që nuk po dua ta cek, që e bëri atë lëshimin, por pastaj edhe kërkoi falje. Prandaj, unë do e mbyll me kaq, dhe si vendim unanimisht të PDK-së, në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës, përjashtim mund të ketë, por 90% do të jemi kundër këtij propozimi, dhe ta shohim si po rrjedh pastaj dhe si po shkon votimi për këtë çështje e cila nuk po besoj që ka me ndikue diçka në të mirë të qytetarëve, në përjashtim që ndoshta ndikon tek partia në pushtet, LDK-ja. Ju falemnderit!

Uran Halimi: Falemnderit, Shpetim! Fjalën po e kërkon z.Nexhat Selaj.

Nexhat Selaj: Falemnderit, kryesues! Përshëndetje kryetar, kolegë asambleistë, media dhe ju të gjithë të cilët po na dëgjoni përmes valëve të Radio Sharrit! Nuk është e çuditshme kjo çka po ndodh sot, pasi që nga festimi i fitores së LDK-së këtu në qytetin e Dragashit, nga fillimi është bishtnue dhe nga fillimi i votave ka qenë ai keqpërdorim të cilin nuk po due të hyj më thellë, pasi që të gjithë veç jemi të njoftuar dhe të gjithë e dimë procesi se si ka vajtur. Nuk po çuditem aq shumë edhe te shkarkimi i kryesuesit, pasi që kjo qeverisje lokale bëri edhe shumë shkelje të tjera. Në radhë të parë, duke shkarkuar drejtor në mënyrë joligjore, duke emëruar drejtor të vetit po ashtu në mënyrë joligjore, duke lëvizur me koalicionin, duke shkarkuar anëtarë të koalicionit. E, krejt së fundi, edhe partnerin i cili erdh në një pozitë dhe falë LVV-së sot qeveris me qeverisjen lokale në qytetin e Dragashit dhe komplet Dragashin. Unë nuk u pajtova me një thirrje të shefit, të kryesuesit të Kuvendit, kur tha kërkoj mbështetjen nga delegatët opozitarë që të mos mbështesin kryetarin për shkarkim. Kryesues, ne as nuk të kemi emëruar, as nuk do të mbrojmë, as nuk do të shkarkojmë. E ke lyp LDK-në Dega në Dragash, ja ku i ke kolegët përpara, kërko ndihmën nga ta. Nga ne, po të jesh do të është mirë, por edhe të mos jesh nuk do të është keq. Kësaj i bjer që të bindesh, të bindeni ju personalisht e para, të binden kolegët tuaj të cilët keni luftuar ditë e natë që ta sillni në pozitë LDK-në. Të binden votuesit të cilët edhe janë harxhue me mjete materiale duke shpërblyer familje në familje, që të krijoni vota. Dhe, tashti ndihmën kërkoje nga LDK. Aq sa janë Samidin, unë nuk do të pengoj fare kur të flasësh ti. 500 vota a 200, ajo është votë e qytetarit, edhe një votë e vetme nëse është, vota është e shenjtë. Kështu që, unë nuk do të hyj aty sa vota ka sjellë, por hyj nga ajo që keni bo një qeverisje për një ndryshim të Dragashit. Ato ndryshime i shofim vetëm nëpër Facebook, duke krijuar selfie të ndryshme, duke bërë fotografi aty ku juve ju konvenon. Kishte me qenë mirë të shiqoni shkollat, kishte me qenë mirë të shiqoni nxemjet nëpër shkolla të cilat, ka ardhë dimri, ne në dy-tri shkolla nuk kemi edhe nxemje. Do të kishte me qenë mirë këto t'i shiqoni. Përkundër asaj, jeni këtu ku jeni, vendosin delegatët, votimi është i lirë. Mirë kishte me qenë ta udhëheqësh edhe pak, po edhe nëse shkarkohesh, fundi i botës nuk është. Falemnderit!

Uran Halimi: Faleminderit, i nderum delegat! Fjalën po e kërkon znj. Afrore Veseli.

Afrore Veseli: Faleminderit për fjalën, z.kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Reagimi im vjen pasi në këtë pikë po kërkohet shkarkimi i kryesuesit që, të them të drejtën, nuk më ka befasuar. Sepse, kur ju nuk mund të ecni mirë, atëherë kërkonit kësi lloj paqartësie. Këtë e kam pritur kur është prishur marrëveshja mes partive, po për çudi zgjati bukur shumë, sa që disa nga njerëzit e LDK-së filluan ta lavdërojnë edhe punën e tij. Sipas mendimit tim, ky qëndrim ka qenë për shkak të mosmarrëveshjeve tuaja kuvendare, se përndryshe shumë moti kishte ndodhur kjo që po ndodh edhe sot. Ju tani mund ta shkarkoni, sepse nuk kam fare dyshimin më të vogël se i keni edhe votat dhe mund të keni shkuar edhe ndonjë blerje eventuale, siç e keni zakon. Por, duhet të bëhemi të sinqertë se shkarkimi nuk po bëhet për mospunën e tij, por për çështje tjera që vetëm ju mund t'i dini. Për këtë që po bëni, nuk po ndryshon asgjë, përveç kufizime në mandatin tuaj. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar z.Nedžmidin Sejdilar.

Nedžmidin Sejdilar: Të nderuar qytetarë, sot jemi mbledhur në këtë seancë të jashtëzakonshme për t'i dhënë vote mosbesimi zotit Kryesues. Megjithatë, ajo që më befasoi në këtë kohë ishte se prisja një seancë të jashtëzakonshme, por për çështje më të mëdha. Për të zgjidhur problemet e qytetarëve. Të shohim se ku kanë ngelur rrugët, asfaltimi, kanalizimet. Së paku prisja që kjo qeveri të caktojë një mbledhje të jashtëzakonshme për zgjidhjen e problemeve të atyre banorëve të fshatit Radeshe, të cilët janë të shqetësuar për lumin e tyre. Dhe pushteti ekzekutiv nuk ka ndërmend t'u përgjigjet në asnjë mënyrë kësaj pyetjeje. Shohim që në politikë gjithçka është e mundur, të gjithë mund të punojnë me të gjithë, është e rëndësishme të arrihen shifrat. Sot më intereson se si do të votojnë në të njëjtën shportë përfaqësuesit e Koalicionit Vakant, përfaqësuesit e JGP-së dhe përfaqësuesit e Unionit Socialdemokrat. Nëse kthehemi dy vjet mbrapa, do të shohim se kryetarja e Unionit Socialdemokrat po pështynte Koalicionin Vakant. pse e përkrahën zgjedhjen e nënkryetarit të komunës z.Fejzal Halilović. Tani më intereson se si do të jenë kunder të gjithë bashkë me Ademin. Tjetër, logjikisht, mendoj se pushteti ekzekutiv ka probleme shumë më të mëdha në këtë komunë sesa shkarkimi i një kryesuesi i Kuvendit, i cili figurativisht luan rolin e konduktorit. Për të marrë shembull një autobus, ne po ndërrojmë konduktorin këtu dhe shoferi na e prishi autobusin. Autobusi është i prishur dhe kërkojmë një defekt me konduktorin. Nuk mendoj se ndërrimi i konduktorit do ta rregullojë atë autobus. Autobusi duhet të mirëmbahet, gomat, vaji e të tjera të ndërrohen që të funksionojë. Konduktori thjesht kujdeset për situatën me pasagjerët dhe lëshon biletat. Sinqerisht, zoti Kryesues, unë nuk ju votova në atë post dhe as nuk kam ndërmend t'ju largoj nga ai post. Asgjë personale, jam shumë i interesuar të shoh se si do të jetë shpërndarja e votave, dhe sinqerisht për hir të qytetarëve të Gorës, më intereson se si mundën të gjithë ata që pështyjnë njëri-tjetrin në mënyrën më të keqe të mundshme. të jenë bashkë sot në të njëjtin projekt. Më intereson se si do t'ua shpjegojnë nesër

qytetarëve të gjithë këta njerëz, si mund të jenë bashkë në të njëjtin kosh Duda Balje, Adem Hoxha, Adnan Redžeplari.

Uran Halimi: Faleminderit! Fjalën e ka kërkuar z.Jetmir Ajdini.

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Kjo thirrje e seancës së jashtëzakonshme për ne nuk paraqet ndonjë risi. Jemi mësuar që të thirrni seanca të jashtëzakonshme pikërisht për këtë pikë të rendit të ditës. Kjo është një pabesi e LDK-së që e ka bërë me ne, me prishjen e koalicionit. Është po e njëjta LDK që tenton prapë me e shkarkuar kryesuesin. Asgjë e jashtëzakonshme nuk ka të bëjë këtu me këtë pikë të rendit të ditës. Kurgjo e jashtëzakonshme nuk është për qytetarët e Dragashit që të shkarkohet kryesuesi, përveç se tentativë e pushtetit për monopolizim të pushtetit, që t'i kenë duart e lira edhe të vazhdojnë gjithçka vetë, qysh jeni mësuar që e kanë mbushur Komunën me aktivistë të vet, me nepotizëm e me të gjitha këto me radhë, që i dini shumë mirë ju edhe qytetarët e Dragashit. Kjo është një tentim për mospunën e tyre, që ta arsyetojnë me shkarkim të kryesuesit e me kësi farë lojnash. Në të mirën e qytetarëve të Dragashit do të ishte që Urani të jetë kryesues i Kuvendit, për arsye se kryetari ish dashtë ta përdorë kryesuesin e Kuvendit që të krijojë ura bashkëpunimi, përmes kryesuesit, me qeverinë qendrore, kur e dimë se qeveria qendrore udhëhiqet nga LVV. E kryetari është dashtë ta shfrytëzojë Uranin dhe të krijojë ura bashkëpunimi, e të përfitojë ndonjë projekt për Komunën nga ministrinë përkatëse, e jo ta ndërmarrë këtë hap dhe t'ia mbyllë dyert vetes, Komunës dhe qytetarëve të Dragashit. Ju ftoj edhe një herë të gjithë asambleistëve, pozitë dhe opozitë, nuk është në interesin e qytetarëve të Dragashit që të shkarkohet kryesuesi, për arsye të cilat i ceka. Gjithashtu edhe asambleistët e komuniteteve, nuk duhet të bini pre e presioneve të cilat jau bënë pushteti. Ju jeni votë, ju përfaqësoni qytetarë, ju i keni projektet e juaja me të cilat kërkonin ndihmë nëpër qeveri, e dini shumë mirë. Unë mendoj që kjo pikë e rendit të ditës nuk duhet të kalojë, për të mirën e qytetarëve të Dragashit. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ajdini! Fjalën e ka kërkuar z.Driton Ademi nga PDK.

Driton Ademi: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Kjo është hera e dytë që po thirrret seanca në fundvit, me seanca të jashtëzakonshme. Na shumë sende kemi me diskutuar për këto seanca, po nuk po e shohim të arsyeshme që në fundvit me i thirrë dy seanca të jashtëzakonshme, kurse shumë sende kemi me diskutuar, që shumë projekte janë pa përfunduar. Këtu sot nuk po të jepet e drejta për me folë për disa projekte që kanë mbetur në gjysë. Domethënë, këto seancat, të dyjat, po na bllokoi fjalinë për me folë për projektet të cilat i ka Komuna. Unë nuk e di ku e ka qëllimin kjo qeverisje, pse na mos me pas të drejtën e fjalës, po këta me i krye punët ditën e natën, qysh janë t'u i krye ditën e natën veç me selfie, t'u ju thënë qytetarëve që na jemi t'u punuar. Nuk punohet me selfie t'u shtruar asfalta, kubëza edhe t'u pastruar lumenjtë. Po Sef, mundish me u kesh, t'u ta pastruar lumin tënd, mundish me u kesh gjithë ditën. Më kallxonin çka jeni t'u bërë ndryshe, përveç që jeni t'u thirrë seanca

të jashtëzakonshme, mos me dalë na me e pas fjalën tonë këtu, edhe me e pa projektet ju ku jeni sivjet. Se jeni reklamue shumë që na jemi t'u punue. Po, jeni t'u punue, për selfie jeni t'u punue dhe qaty jau zo... shpenzimet ma të mëdhaja bon vaki jeni t'u i bo në telefona, jeni t'u i mbush telefonat, edhe atë me Gigabajt, jo veç me bateri. Sot nuk po më vjen çudi që ka ardhë kjo pikë e rendit të ditës, se se moti e keni thonë që kemi me e shkarkue kryesuesin. Ju nashta mundeni me i pas votat, po ju jeni konë ata të cilët e keni emërue këtë kryesues. Edhe shpresoj, qe drejtori kongra këtu edhe haptas ka votue herën e mromë, kisha pas qef me ta pa t'u votue edhe për shkarkim drejtor, po s'je në Asamble. Kështu që, ne si PDK dhe unë si asambleist, herën e mromë kur është votue kryesuesi una jam konë kundër, edhe sot do të jam kundër shkarkimit të kryesuesit. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, z.Ademi! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën?

Nja dy fjalë po due me u ndërlihdë me parafoëlsit e mi. Munir Jonuzi e ka kërkuë fjalën.

Munir Jonuzi: Të nderuar të pranishëm, ky kuvend i jashtëzakonshëm u caktua sot me iniciativën e shumicës së delegatëve. Ne e dimë se një e treta e votave të numrit të përgjithshëm të delegatëve kërkohet për të caktuar një asamble të tillë. Në këtë rast, u deshën nëntë. Nuk do të komentoj nëse kryesuesi ka qenë i mirë apo jo, do t'i përgjigjem vetëm kolegut Nedžmidin në thirrjen që iu drejtua delegatëve nga komuniteti jo-shumicë. Ai tha, si mund të jesh në të njëjtën shportë. Zoti Sejdlar, ju e dini se në politikë gjithçka është e mundur, mund të bëhen koalicione jo parimore, ka mundësi që mandatin e kaluar keni qenë me LDK-në dhe tani jeni me PDK-në. Ka mundësi që të jeni me Lëvizjen, ka mundësi që nesër të keni të njëjtin qëndrim me Vakatin. Mund të ketë LDK- dhe VV, por jo tani, mund të jetë LDK-ja dhe PDK-ja bashkë, këtë e dimë sepse kemi pasur një qeverisje të tillë. Të gjithë mund ta bëjnë, por delegatët e komunitetit joshumicë, nëse kanë të njëjtin qëndrim, nuk mund ta bëjnë. Kolege Nedžmidin, nëse dikush nga komuniteti shumicë do ta thoshte këtë, do të thosha se ky është diskriminim i pastër. Të gjithë mund ta bëjnë këtë, por ju na ndaloni. Pse kolegu Nedžmidin.

Uran Halimi: Faleminderit, zv/kryesues! Një minutë replikë e ka z.Sejdlar.

Nedžmidin Sejdlar: Koleg Jonuzi, nuk të kam ndaluar asgjë. Unë thjesht po deklaroja se jeni të gjithë në të njëjtën shportë. Mund të bësh çdo gjë, po them vetëm se je në të njëjtën shportë. Dhe se nuk i keni prioritetet që u premtuat qytetarëve. Nuk mund të më thoni se herën e kaluar kam qenë në koalicion me LDK-në dhe tani që jam në koalicion me PDK-në, nuk jam larguar nga parimet politike apo nga ajo që u kam premtuar qytetarëve. Dhe ju koleg Jonuzi e pështyve me Ademin, me zonjën Balje dhe tani jeni bashkë. Kjo nuk është e qartë për mua. Ndryshe, është fakt që ka koalicione jo parimore. Nuk ia kam ndaluar askujt asgjë, po them vetëm se Duda Balje, Adem Hodža, Adnan Redžeplari janë sot në të njëjtin kosh dhe kanë pikëpamje dhe parime të ndryshme politike. Ata pështyjnë njëri-tjetrin, por kur bëhet fjalë për interes personal dhe personal ala franco, janë të gjithë

bashkë.

Uran Halimi: Faleminderit, i nderuar! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Siç thashë edhe ma herët, deshta me u ndërlidhë pak me parafolësit. Plotësisht me të drejtë, sidomos kuvendarët e GP të PDK-së, është e vërtetë që jemi njerëz edhe mundemi edhe me gabue. Ajo çka ka ndodhë prej në fillim, siç e potencoi z.Selaj, edhe u prit, se pak a shumë është diskutue, edhe zakonisht janë shque si parti e të pabesëve. Të më falni për fjalorin, por po më duhet me e thënë. Mirëpo, është dashtë qytetari me e pa fytyrën e vërtetë të tyre. Jo rastësisht thonë që nuk vdesish pa u korit. Ishalla Zoti na ruan nga kjo pjesë, e vdesim kështu faqebardhë! Mirëpo populli i Opojës, i Dragashit në përgjithësi, është populli aftë edhe i shkathët. Ata dinë edhe me të dënue, edhe me të përkrah, kur duhet. Kështu që, janë qytetarët ata që kanë me vendos. Gabimet ndodhin, se jemi njerëz, nuk jemi të perfeksionuet., mirëpo qytetari e di se çka ka ndodhë prej ma herët e deri tash. Po besoj që në fund gjithçka do të paguhet në mënyrën më të mirë të mundshme. Sidoqoftë, po e qesim në votim, meqenëse s'ka kërkesa për fjalë, po e qesim në votim rendin e ditës. Kush është pro këtij rendi të ditës? Kush është kundër këtij rendi të ditës? Abstenim? Atëherë i kemi 15 vota pro, 4 kundër edhe 7 abstenime. Kalon rendi i ditës. Po vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. Është shkarkimi i kryesuesit të Kuvendit të Komunës. Ne veç e shterrëm debatin për kryesuesin, ato çka patëm me i thënë. Nëse dikush do me e shfrytëzue edhe kohën e kësaj pike, munden me e marrë fjalën. z.Naser Myrtezani e kërkoi fjalën.

Naser Myrtezani: Faleminderit! I nderuar kryetar, të nderuar kolege dhe kolegë delegatë! Meqenëse u shterrën të gjitha diskutimet edhe më herët, edhe veç ne e dimë që jemi mbledhë për pikën e rendit të ditës, atëherë kërkojmë nga të gjithë delegatët që të votojnë pro shkarkimit të kryesuesit. Por, kryesues, një gjë ta kisha kërkuar, që për atë edhe dola këtu, Më 8 shkurt të vitit 2022, kur kam kërkuar shkarkimin tuaj – nuk kam asgjë personale, por politika është kjo e cila duhet t'i lëvizë gjërat tutje – unë i kam edhe screen që njerëz të caktuar, nuk po them tuajt, ndoshta të partisë tuaj, më kanë kërcënuar, më kanë sharë me familje. Dhe, ju kisha kërkuar, nëse ndodhë një gjë e tillë, ju lutem mos hyni në gjëra familjare. Nëse keni diçka, jam këtu ai i cili duhet të përballem, por jo me fyerje, me sharje, se janë të ulëta. I kam screen-at aty, dhe tani me ma sharë familjen pse unë po kërkoj një gjë të tillë, që më ka rënë hise që unë të përfaqësoj partinë time, kërkoj me mirëkuptim, të jemi konstruktivë në këtë drejtim. Politika është kjo që i balancon gjërat. Ma herët unë e dëgjova edhe qasjen e opozitës që ju qas këtu diskutimit. Ju qasën edhe delegatët e partisë suaj, përmendën nepotizëm e gjithçka. Mos të hyjmë në këso çështje, për faktin se e dimë qasjen e secilës parti politike. Dhe, ju kërkoj me mirëkuptim edhe një herë, si koleg, që gjërat të merren në mënyrë paqësore, në mënyrë demokratike, në mënyrë politike Prandaj edhe jemi këtu, për të bërë politikë, për të diskutuar, për të analizuar. E tëra kjo ka qenë, shkeljet e tua që kanë qenë sistematike, të punës së Asamblesë, mosrespektimi i fjalës së asambleistëve, përfaqësuesve të ekzekutivit, të qenit selektiv në krijimin e

hapësirës për diskutim jashtë rendit të ditës, trajtimi i pabarabartë dhe jokorrekt i anëtarëve të ekzekutivit gjatë raportimit për pikat brenda rendit të ditës. Pra, këto janë ato për të cilat ne kemi kërkuar dhe, unë edhe atëherë që kam kërkuar një gjë të tillë. Prandaj, me mirëkuptim të them që mos ta merrni këtë të tensionume, mos ta merrni këtë në mënyrë të vrazhdë, mirëpo duhesh me e ditë se gjithçka mund të ndodhë, se në politikë 2+2 kurrë nuk bëjnë 4, por gjithmonë gjërat lëvizin në bazë të situatave që mund të ndodhin në momente të caktuara. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, i nderum delegat! Veç një sekond, një replikë e kam me z.Myrtezani. Okej, Shpetim Hajredini e ka fjalën.

Shpetim Hajredini: Atëherë, po ju kërkoj falje të gjithëve, por e kemi një arsye shumë të fortë, nëse na ish mundësue t'i kemi nha 10-15 minuta pauzë. Për arsye shëndetësore të një asambleisti.

Uran Halimi: Faleminderit! GP i PDK-së ka kërkuar një pauzë për arsye të ndjeshme. Në ora 10:30 rikthehemi në sallë.

Po vazhdojmë pas asaj pauzës të cilën e kërkoi GP i PDK-së. Mbetëm te vazhdimi i fjalimit. Unë pata me e bo një replikë, po në pamundësi u dashtë me e bo qetash. Po ndërlihem te fjalimi i z.Myrtezani. Ju zakonisht në LDK e keni qef me e viktimizue veten. Specialitet e keni këtë. Në këtë rast edhe z.Myrtezani tha që dikush e paska kërcënuar, mbase edhe mund të jetë i joni, sipas paragjykimëve edhe pretendimeve të zotëriut në fjalë. Po të ftoj që ata emra që të kanë kërcënuar me i çue në hetuesi, në polici. E ftoj hetuesinë edhe instancat ligjzbatuese që z.Myrtezani ta ftojnë në një intervistë edhe t'i shohin kush janë ata që e kanë kërcënuar. Nuk e amnistoj, qoftë ai edhe vëllai jem. z.Myrtezani, na nuk kemi ardhë këtu me kërcënime, as me shantazhe, jemi Kuvend edhe vend demokratik. Edhe pse ju vazhdimisht tentoni me e mbyt demokracinë. Unë kam qef me u konë shumë liberal edhe i drejtpërdrejtë. Andaj, të ftoj që emrat të cilët ty të kanë kërcënuar, kushdoqofshin ata, mundësisht dërgoi në polici. Faleminderit shumë! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Shpetim Hajredini e ka kërkuar fjalën.

Shpetim Hajredini: Atëherë, së pari po ju kërkoj falje për kohën që jua humbu, por ishte e arsyeshme. Gjithashtu, unë jam me të vërtet i emocionuar, por jam edhe i obliguar që si shef i Grupit ta kërkoj kjo seancë të shtyhet për një ditë tjetër, pasi që për ne është shumë më e rëndësishme jeta e një kolegut, sesa votimi apo marrja e vendimit të shkarkimit të kryesuesit. Ne si parti nuk do të vazhdojmë të qëndrojmë në seancë, do të dalim dhe nga këtu do të shkojmë direkt të kolega. Ju faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, mirëpo ka qenë mirë, meqenëse e ke propozuar, me e qit në votim.

Atëherë, të nderum delegatë, unë edhe më herët thashë, po na përcjellin qytetarët edhe s'po më pëlqen me e diskutue edhe arsyen, por ishte arsyeja e ndjeshme. Kush është pro propozimit të z.Hajredini që kjo seancë të shtyhet për një datë tjetër? Kush është kundër që kjo seancë të shtyhet për një seancë

tjetër? Abstenim? I kemi 11 vota pro propozimit të z.Hajredini, i kemi 13 vota kundër propozimit të z.Hajredini. Shihet qartë që kur është në pyetje shkarkimi i kryesuesit, jeta le të na shkojë për dëm, s'është problem.

Artan Loshaj: Po më vjen keq që dola këtu, po këtu po shihet qartë se kjo LDK nuk i intereson as jeta e një qytetari. Kanë pas arsye se s'kanë pas vota, edhe sa na kanë thirrë në seancën e jashtëzakonshme, e kanë ndërpre të jashtëzakonshmen, prapë kanë qit të jashtëzakonshme. Domethënë, këtu po shihet qartë se këtyre nuk iu intereson qytetari, nuk iu intereson kërkush, këtyre iu intereson vetëm pushteti edhe pozitrat të cilat i kanë prit 14 vjet. Ditën e mirë!

Uran Halimi: Faleminderit, i nderum! Fjalën e ka z.Nedžmidin Sejdlilar.

Nedžmidin Sejdlilar: Ajo që po ndodh sot këtu është e tmerrshme. Shefi i Grupit Parlamentar të PDK-së kërkoi që seanca të shtyhet për shkak të problemeve shëndetësore të kolegut tonë, por ne vetëm këtu konfirmuam se jemi në gjendje të vrasim dikë për interes personal. Zoti Xheladini, që nga fillimi i mbledhjes së këtij kuvendi, më bëni presion rregullisht. Po te lutem per here te fundit qe te mos e besh kete. Deri para pak kohësh isha në humor të mirë dhe mund të të duroja. Por tani nuk do ta bëj më. Unë dhe ti nuk jemi nga e njëjta parti. Ju nuk jeni as i afërmi im dhe nuk mund të më këshilloni, dhe ju lutem mos më provokoni. Këtu po shpreh mendimin tim, për të cilin kam të drejtë, nëse nuk jeni dakord me të, mund të më përgënjeshtroji. Por mos më ushtroji më presion këtu. Çdo seancë ju i bëni presion dikujt. Jam unë ose dikush tjetër. Ju lutem qetësohuni dhe ju zotërinj nga LDK-ja, ju lutem qetësoni këtë zotëri. Nuk do ta duroj më këtë. Do të vij në seancat sa të kem frymë. Dhe nëse ka nevojë do të thërras KFOR-in që të më mbrojë dhe do të vij këtu dhe askush nuk do të mund të më frikësojë.

Uran Halimi: z.Samidin, a dësh me e marrë fjalën? Hajde!

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm edhe LDK është parti demokratike. Parti demokratike e botës, jo e Kosovës. Tha që ne jemi në gjendje me mbyt njerëz, foli në shumës "NA". Mund të folë për veten e vet, unë i thashë mundesh me folë për veten tënde. Por mu edhe neve s'mundesh me na përfshi se ne jemi në gjendje me mbyt njerëz. Na kurrë s'kemi mbyt njerëz, na jo. Edhe mos na drejto neve me ata që mbysin njerëz. Për atë reagoja, të lutem, s'ka kërcënim këtu. Ti folë në emër tonin, që na jemi në gjendje me mbyt njerëz. Ti mbash përgjegjësi për këtë, a e dish çfarë fjalë e madhe është. Edhe ti çka po dësh me thënë këtu? Se na duhet me hesht, për hir të transparencës, për hir të demokracisë? Të lutem!

Uran Halimi: Faleminderit! Kryetari e ka kërkue fjalën.

Bexhet Xheladini: Faleminderit! I nderuar zv/kryesues, delegatë! Unë dy herë bisedova me telefon me internistin kardiolog, i cili është duke e trajtuar Masarin dhe ai dy herë më konfirmoi se gjendja e Masarit është stabile dhe është nën kontroll, nuk ka aspak rrezik për jetën e tij. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, kryetar! Fjalën e ka kërkuar z.Jetmir Ajdini.

Jetmir Ajdini: Atëherë, pasi gjërat ndodhën kështu siç ndodhën dhe ndodhi ky problemi shëndetësor i asambleistit, besoj që është njerëzore më së pari që të shtyhet kjo seancë edhe të thirret për një datë tjetër. Asgjë të keqe nuk ka nëse shtyhet për një datë tjetër. Si VV konsiderojmë që shumë më e rëndësishme është që jeta e një asambleisti të jetë mirë dhe shpresojmë që asambleisti jonë është mirë dhe do të vjen prapë të na bashkëngjitet këtu. Do ta lëshojmë seancën në mbështetje edhe në përkrahje morale së paku të një kolegu tonë. Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, Jetmir! Meqenëse Jetmiri veç e kërkoi edhe është shef i GP i joni, atëherë më duhet edhe unë të solidarizohem të paktën për një koleg tonin. Mirë u pafshim në seancat e radhës!

Munir Jonuzi: Të nderuar delegatë, meqenëse një grup delegatësh është larguar nga seanca, do të konstatoj nëse kemi kuorum për të vazhduar këtë seancë. Duke pasur parasysh se më shumë se gjysma e delegatëve të këtij kuvendi janë të pranishëm, deklaroj se kemi kuorum për ta mbajtur këtë seancë. Deri më tani kemi debatuar për pikat e rendit të ditës, në radhë të parë për pikën e parë të rendit të ditës. Dhe tani, nëse nuk ka diskutues të tjerë, mbetet vetëm votimi. A don të merr fjalën dikush? Nëse nuk ka, ftoj delegatët e pranishëm që të deklarojnë për pikën e parë të rendit të ditës, e që është Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit. Kush është PRO?, kush është KUNDËR?, ABSTENIM?. Me 15 vota PRO, një KUNDËR, një ABSTENIM deklaroj se kemi shumicën për shkarkimin e Kryesuesit të Kuvendit. Zoti Kryetar dhe zoti Adem, në bazë të ligjit për vetëqeverisje lokale, mund të deklaroj nëse duam të votojmë me votim të hapur apo të mbyllur. Këtu kthehem te fillimi i këtij procesi dhe shtroj pyetjen, duam të votojmë të hapur apo të mbyllur. A doni që ne të votojmë publikisht? Kush është pro votimit të hapur. Kush është PËR? kush është KUNDËR?. TË ABSTENIM?. Me 16 vota PRO, 0 KUNDËR, 0 ABSTENIM, deklaroj se është vendosur që të votohet publikisht, se delegatët e këtij kuvendi kanë vendosur të votojnë publikisht. Tani po e hedh në votim pikën e parë të rendit të ditës, pasi do të votojmë publikisht, i kërkoj të gjithë delegatëve të deklarojnë nëse janë PRO Shkarkimit të Kryesuesit të këtij kuvendi. Kush është PRO?, kush është KUNDËR?, ABSTENIM?. Deklaroj se me 15 vota PRO, 0 vota KUNDËR dhe 1 votë ABSTENIM u miratua kjo pikë e rendit të ditës që është Shkarkimi i Kryesuesit të Kuvendit.

Pika e dyte

Munir Jonuzi: Kalojmë te pika e dytë e rendit të ditës. A don të flasë dikush për këtë pikë të rendit të ditës?

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë! Në seancën e kaluar kemi vendosur që pronat NN (14 prona) të cilat nuk janë në pronësi të askujt, kemi vendos që këto prona të barten në pronësi të Kuvendit Komunal. MAPL na ka kthye lëndën në rishqyrtim, me arsyetimin se e ka kundërshtuar këtë AKP-ja, mirëpo ajo nuk ka ofruar asnjë argument që prona është e tyre. Kështu që, unë u propozoj

delegatëve që ky Vendim të mbetet edhe më tutje. Faleminderit!

Munir Jonuzi: Ju faleminderit zoti Kryetar. A don dikush tjetër për të folur.. Meqenëse askush nuk dëshiron të flasë, unë e vendosi këtë pikë të rendit të ditës në votim. Kush është PËR propozimin e Kryetarit? Kundër?, Abstenuar?. Deklaroj se me 14 vota PRO, 0 KUNDËR dhe 0 ABSTENIM, miratohet kjo pikë e rendit të ditës.

Pika e trete

Munir Jonuzi - Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, që është propozimi për vendim: A dëshiron dikush të flasë? Zoti Kryetar, ju lutem.

Bexhet Xheladini: Të nderuar delegatë, i nderuar zv/kryesues! Ju e keni marrë materialin, që ne si ekzekutiv e kemi mbështet kërkesën e qytetarëve të Dragashit për gjetjen e një trualli për vendosjen e një trafoje për nevojat e tyre. Mirëpo, pasi që kërkesa nuk është kompletuar – unë e kam thirrë së paku pesë herë KEDS-in që ta bjer edhe ai kërkesën – dhe ata nuk e kanë prurë deri në këtë moment. Pasi që kërkesa është a pakompletume, unë propozoj që kjo pikë e rendit të ditës të refuzohet dhe të merret një vendim kundër, për shkak të moskompletimit të kërkesës nga ana e KEDS-it.

Munir Jonuzi: A dëshiron dikush të flasë? Pasi nuk ka, kush është ta shtyjme këtë pikë të rendit të ditës, për shkak të mosplotësimit të materialeve, për ndonjë senacë të tjetër. Kush është PRO? kush është KUNDËR? ABSTENIM?. Deklaroj se me 14 vota PRO, 0 KUNDËR, 0 ABSTENIM, kjo pikë nuk kaloi në rendin e ditës. Duke qenë se i kemi ezauruar të gjitha këto pika, ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj dhe me këtë e përmbyllem këtë kuvend të jashtëzakonshëm.

Kryesuesi i Kuvendit:
